



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës  
Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih struĉnjaka Kosova  
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
 		
Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih struĉnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARKIV ARHIV ARCHIVE		
Nr. Prot Proj. prot Prot. no	Nr. i faq. Br. str. No. page	Data: Datumi Date
147	7	02.03.2026
PRISHTINE - Prishtina - PRISTINA		

## RREGULLORE

# RREGULLORE PËR NDARJEN DEKORATIVE, ÇMIMIT VJETOR DHE MIRËNJOHJEVE PËR ANËTARËT E ODËS SË INFERMIERISË, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS (OIK)

Prishtinë, 2026

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1 dhe nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, neni 19, nënparagrafi 1.1 dhe 1.21 dhe nenit 26 nënparagrafi 2.2 të Statutit të OIK neni 15 paragrafi 10 të Rregullores për Punën e Kuvendit, e miratuar në mbledhjen e rregullt të datës 27.02.2026, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR DHËNIEN E DEKORATAVE, ÇMIMIT VJETOR DHE MIRËNJOHJEVE**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim caktimin e kritereve dhe procedurave për ndarjen e dekoratave, çmimit vjetor dhe mirënjohjeve për anëtarët e OIK, me qëllim të vlerësimit të kontributit të Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë.

#### **Neni 2 Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- **Dekorata** – Vlerësimi më i lartë i OIK për anëtarët kontribut-dhënës në fushën e infermierisë dhe profileve të cilat përfaqëson OIK.
- **Çmimet** – që jepen për anëtarët e OIK të propozuar nga institucionet shëndetësore.
- **Mirënjohje** – e cila u jepet anëtarëve të Odës dhe individëve të tjerë, institucioneve, organizatave, shoqatave dhe personave juridikë për dhënien e kontributit të çmueshëm në punën dhe organizimin e Odës.
- **Revokim i dekoratës** – heqja e së drejtës dikujt për bartjen e Dekorates së dhënë nga Oda.
- **Komisioni për Dhënien e Dekoratave** – Organ i OIK i cili është përgjegjës për shqyrtimin, vlerësimin dhe për zgjedhjen e kërkesave për dhënien e dekoratave.

## **II. DEKORATAT, ÇMIMI VJETOR DHE MIRËNJOHJET**

### **Neni 3**

#### **Llojet e dekoratave dhe çmimeve**

1. Oda e Infermierëve të Kosovës do të ketë 3 lloje të dekoratave, si në vijim:
  - 1.1. Dekorata Nderi;
  - 1.2. Çmimi vjetor i Odës së Infermierëve të Kosovës
  - 1.3. Mirënjohje:
    - 1.3.1. për kontribut të shquar në profesion
    - 1.3.2. për angazhim humanitar dhe kontribut në komunitet
    - 1.3.3. për kontribut të veçantë në zhvillimin e OIK
    - 1.3.4. për Arritje shkencore.

### **Neni 4**

#### **Rregullat për Dekoratat, Mirënjohjet dhe Çmimin Vjetor**

1. Pamja vizuale (dizajnimi) i llojeve të dekoratave, mirënjohjeve dhe çmimit vjetor të dhëna nga OIK sipas pikës 1 të këtij neni përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Odës.
2. E njëjta dekoratë apo çmim vjetor nuk mund t'i jepet dy herë të njëjtit person.
3. Dhënia e dekoratave mund të shoqërohet me një shpërblim në të holla, sipas kritereve që do të caktojë Këshilli Drejtues i Odës.

### **Neni 5**

#### **Dekorata Nderi**

Dekorata e Nderit, si vlerësimi më i lartë i Odës, u jepet anëtarëve të Odës për arritje të jashtëzakonshme profesionale gjatë ushtrimit të profesionit të infermierisë që kanë kontribuar në ofrimin të shërbimeve shëndetësore dhe në sistemin e kujdesit shëndetësor në tërësi, si dhe për kontributin e dhënë në situata të krizës sociale ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme për shëndetin publik.

### **Neni 6**

#### **Dhënia e propozimit për dekoratat e Odës së Infermierëve të Kosovës**

1. Propozimi për dhënien e dekoratave mund t'i dorëzohet Këshillit Drejtues të Odës drejtpërdrejt nga:
  - 1.1. Kryetari i Odës;
  - 1.2. Këshilli Drejtues i Odës;
  - 1.3. 1/3 e Anëtarëve e Kuvendit të Odës;

- 1.4. Me iniciativën (peticion) e së paku 5% të numrit të përgjithshëm të anëtarë të Odës.
2. Propozimi për dekoratë dhe çmimet vjetore është i plotë nëse shoqërohet me arsyetim përkatës ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të të propozuarit me biografi të personit të propozuar.
3. Anëtarët e Odës nuk mund ta propozojnë vetveten për dhënien e dekoratës dhe çmimit vjetor.
4. Miratimi i propozimeve për dekorata është e drejtë e Këshillit Drejtues, i cili vlerëson propozimin, e miraton ose nuk e miraton, vendos për të dhënë dekoratë tjetër nga ajo që është propozuar ose e riformulon arsyetimin.

#### **Neni 7**

##### **Dhënia e Dekoratës pas vdekjes**

1. Dhënia e Dekoratës pas vdekjes së të dekoruarit i bëhet familjarëve të tij: bashkëshortit/es, fëmijëve, të adoptuarve, nipërve/mbesave, prindërve, adoptuesve, vëllezërve dhe motrave të të dekoruarit.
2. Nëse i dekoruari nuk ka anëtar të familjes sipas paragrafit 1 të këtij neni, dhënia e Dekoratës publikohet në faqen zyrtare të Odës dhe ruhet si një pasuri e Odës.

#### **Neni 8**

##### **Mënyra e dhënies së dekoratave**

1. Për kohën, vendin dhe mënyrën e dhënies së dekoratave vendos Këshilli Drejtues i Odës, ndërkaq i dorëzon Kryetari i Odës ose personi i autorizuar prej tij.
2. Nëse i dekoruari nuk pranon ta marrë Dekoratën, atëherë veprohet sikurse Dekorata të mos ishte dhënë fare.
3. Vendimi për dhënien e dekoratave publikohet në faqen zyrtare të internetit të Odës.
4. Vendimi për dhënien e dekoratave regjistrohet në Librin e veçantë të dekoratave, e cila mbahet në arkivën e Odës.

#### **Neni 9**

##### **Revokimi i dekoratës**

1. Të dekoruarit mund t'i revokohet Dekorata nëse vepron në kundërshtim me Kodin Etik të Odës, moralin dhe kryen vepra të tjera që e bëjnë të padenjë për bartjen e Dekoratës.
2. Propozimin për revokimin e dekoratës mund ta bëjnë iniciuesit për dekoratë.
3. Kryetari i Odës, me aprovim të Këshillit Drejtues, nxjerr vendim për revokimin e dekoratës anëtarit të Odës.
4. Vendimi për revokimin e dekoratës publikohet në faqen zyrtare të internetit të Odës.

**Neni 10**  
**Çmimi Vjetor i Odës së Infermierëve të Kosovës**

1. Çmimet vjetore të Odës së Infermierëve të Kosovës ndahen mbi këto baza:
  - 1.1. Anëtarit të Odës i cili me punën e vet profesionale në praktikën profesionale ka arritur rezultatet të larta profesionale.
  - 1.2. Propozimet për çmim vjetor të Odës jepen nga institucionet shëndetësore në tri nivelet e kujdesit shëndetësorë publik dhe institucionet private shëndetësore.
2. Kandidati duhet të jetë aktiv, të ketë performancë të lartë profesionale dhe etike në vendin e punës.
3. Të ketë kontribuar në avancimin e infermierisë, mamisë apo profesioneve të tjera shëndetësore.
4. Të ketë ndikuar pozitivisht në komunitet dhe në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore.
5. Kandidati duhet të jetë anëtar i rregullt i OIK dhe të ketë së paku 5 vjet përvojë pune.
6. Thirrja për aplikime do të bëhet për çdo vit në muajin nëntor, dhe afatet për dorëzimin e aplikimeve do të jetë deri me 1 dhjetor të çdo viti.
7. Institucioni propozues duhet të dorëzojë të përzgjedhurin brenda këtij afati. Propozimet jashtë afatit nuk do të merren parasysh.
8. I/e përzgjedhuri do të njoftohen paraprakisht dhe do të ftohet të marrin pjesë në ceremoninë e ndarjes.
9. Çmimi vjetor do të dorëzohet nga Kryetari i OIK dhe personalitete të shquara nga fusha e shëndetësisë.
10. Këshilli Drejtues i Odës vendos mbi pamjen, formën dhe stimulimet tjera të çmimit vjetor të Odës.
11. Çmimi vjetor do të ndahen në një ceremoni zyrtare të organizuar nga OIK, në fund të vitit.

**Neni 11**  
**Mirënjohjet**

1. Mirënjohjet u jepet anëtarëve të Odës, që kanë kontribuar në ofrimin të shërbimeve shëndetësore dhe në sistemin e kujdesit shëndetësor në tërësi, institucioneve, organizatave, shoqatave dhe personave juridikë për dhënien e kontributit të çmueshëm në punën dhe organizimin e Odës dhe për dhënien e kontributit në promovimin e vlerave të Odës e për ndihmën në realizimin e detyrave, programeve, projekteve dhe qëllimeve thelbësore të Odës në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit.
2. Mirënjohja u jepet anëtarëve të Odës për kontribut të veçantë edhe pas daljes në pension.
3. Mirënjohja i jepet një anëtarit të Odës pas vdekjes si shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për kontribut të veçantë në dhënien e shërbimeve shëndetësore popullatës së Kosovës.

## **Neni 12**

### **Mënyra e ndarjes së mirënjohjeve**

1. Mirënjohjet do të ndahen në një ceremoni zyrtare të organizuar nga OIK.
2. Të përzgjedhurit do të njoftohen paraprakisht dhe do të ftohen të marrin pjesë në ceremoninë e ndarjes.
3. Mirënjohjet do të dorëzohen nga Kryetari i OIK dhe personalitete të shquara nga fusha e shëndetësisë.

## **III. KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN E DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE VJETORE**

### **Neni 13**

#### **Përbërja e Komisionit Vlerësues**

1. Komisioni vlerësues përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Odës që emërohen nga Këshilli Drejtues i Odës me propozim të Kryetarit të Odës, ku njëri prej tyre zgjidhet Kryetar i Komisionit.  
1.1. Njëri nga anëtarët duhet të jetë sipas fushës së veprimit të përcaktuar në përkufizim.
2. Mandati i Komisionit përcaktohet nga organi i cili e ka emëruar, përkatësisht Këshilli Drejtues i OIK.
3. Nëse Kryetari i Komisionit ose një anëtar i Komisionit mungon pa arsye më shumë se tri herë në takimet e Komisionit ose nuk i përmbush detyrat e veta në punën e Komisionit, Kryetari i Odës mund t'i propozojë Këshillit Drejtues të Odës shkarkimin e tij dhe emërimin e një anëtari të ri.
4. Detyrat administrative për nevojat e Komisionit ofrohen nga Shërbimi Profesional i OIK, i cili emërohet nga Kryetari i Odës.

### **Neni 14**

#### **Fushëveprimi i Komisionit**

1. Komisioni mbledh dhe shqyrton propozimet për dhënie apo revokimin e dekoratave dhe çmimeve vjetore dhe përgatit propozimin përfundimtar.
2. Këshilli Drejtues i Odës përcakton punën e Komisionit Vlerësues për dekorata dhe çmimet vjetore me një akt të veçantë.

### **Neni 15**

#### **Masa në rast të parregullsive**

1. Nëse gjatë procesit të aplikimit/përzgjedhjes identifikohen parregullsi ose shkelje të procedurës, OIK do të hapë një hetim dhe do të marrë masat përkatëse.

2. Masat përfshijnë, por nuk kufizohen në, anulimin e aplikimeve të dyshimta ose përjashtimin e aplikantëve që kanë shkelur rregullat e përcaktuara.
3. Çdo vendim për masa disiplinore do të merret në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse.

#### IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

##### Neni 16 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Odës së Infermierëve të Kosovës.

Prishtinë, 27.02.2026



Kryetare e OIK  
Nexhmije Gori